<p>shkrim e lexim. Ky person mundet me qenë në lidhje farefisnore me palën e shurdhër, memec apo shurdhmemec apo nëse nuk ka interes personal në punën juridike që është lëndë e aktit noterial.</p> <p>5. Nëse ndonjëri nga palët është i verbër, e shurdhër apo memece, dëshmitarët duhet të jenë të pranishëm kur palët japin deklaratën për disponim e cila shënohet në aktin origjinal, apo kur palëve ju lexohet tërë teksti i aktit, ose kur ata e lexojnë atë vet, apo kur palët deklarojnë pajtimin e tyre dhe kur e nënshkruajnë aktin. Kjo shënohet në aktin origjinal.</p> <p>6. Në rastet e parashikuara në paragrafët 4 dhe 5 të këtij neni , noteri duhet të bindet se personi i besueshëm din të merret vesh nëpërmjet shenjave me personin e shurdhër, memec, apo shurdhmemec, dhe në aktin origjinal noterial shënohet se për atë është bind.</p> <p><b>KAPITULLI VII - PËRPUNIMI I AKTEVE NOTERIALE</b></p>	<p>concerned party, if he or she does not have a personal interest in the legal transaction which is the subject matter of the deed.</p> <p>5. If a party to the notarized deed is blind, deaf or mute, the witnesses must be present when the parties issue a statement on disposal that would be entered into the original, or when reading the whole original to the parties, or when they are reading it themselves, or when the parties state their agreement and sign the original. This shall be reflected in the original deed.</p> <p>6. In the cases provided for in paragraphs 4 and 5 of this Article, the notary shall ascertain that the person can communicate by sign language with the deaf, mute or deaf and mute person, and shall reflect the steps taken in this regard in the original deed.</p> <p><b>CHAPTER VII - PROCESSING OF NOTARIZED DEEDS</b></p>	<p>rodbinskoj vezi sa gluvo, nemom ili gluvonemom strankom ali ne može imati ličnog interesa od pravnih poslova koji su predmet javnobeležničkog dokumenta.</p> <p>5. Ako je jedna od strana slepa, gluva ili nema, svedoci moraju prisustvovati kada stranka daje izjavu o svojoj volji koja se beleži u originalni javnobeležnički dokument, ili kada se strankama čita čitav tekst javnobeležničkog dokumenta, ili kad ga same čitaju, ili kada stranke izjave svoju saglasnost i kada potpisuju javnobeležnički dokument. To se beleži u originalni javnobeležnički dokument.</p> <p>6. U slučajevima predviđenim stavovima 4 i 5 ovog člana, notar mora utvrditi da se pouzdano lice može sporazumeti putem znakovnog jezika sa gluvom, nemom ili gluvonemom osobom, a u originalnom javnobeležničkom dokumentu navodi da je u to uveren.</p> <p><b>POGLAVLJE VII - SASTAVLJANJE JAVNOBELEŽNIČKIH DOKUMENATA</b></p>
--	--	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 39 Përpilimi</b></p> <p>1. Dokumentet noteriale përpilohen nga noteri, në pajtim me nenin 31 të këtij ligji.</p> <p>2. Paragrafi 1 i këtij neni nuk përjashton mundësinë që tekstin e aktit mund ta përpilojnë edhe palët apo përfaqësuesit e tyre ligjor, i cili mund të vërtetohet apo solemnizohet nga noteri në pajtim me këtë ligj.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 39 Compiling</b></p> <p>1. Notarized deeds are compiled by the notary, in compliance with Article 31 of this Law.</p> <p>2. The Paragraph 1 of this Article does not exclude the possibility of parties or their legal representative from preparing the text of the deeds themselves, which can be verified or solemnised by notary according this law.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 39 Sastavljanje</b></p> <p>1. Javnobeležnička dokumenta sastavlja notar, u skladu sa članom 31. ovog zakona.</p> <p>2. Stav 1 ovog člana ne isključuje mogućnost da tekst dokumenta mogu sastaviti i stranke ili njihovi pravni zastupnici i koji može se overiti ili solemnizirati od notara u skladu sa ovim zakonom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 40 Detyrueshmëria e akteve noteriale</b></p> <p>1. Në formën e aktit noterial sipas nenit 42 të këtij ligji përpilohen:</p> <p>1.1. punët juridike objekt i të cilit është bartja apo fitimi i pronësisë apo të drejtave të tjera sendore në paluajtshmëritë;</p> <p>1.2. themelimi i hipotekës në pronën e paluajtshme.</p> <p>2. Punët juridike nga paragrafi 1 dhe 4 të këtij neni të cilët janë përpiluar në formën e aktit noterial e kanë forcën provuese të njëjtë sikurse të jenë përpiluar në gjykatë</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 40 Obligatory Notarized Deeds</b></p> <p>1. According Article 42 of this law, the following require notarial formats for notarized deeds:</p> <p>1.1. legal activities, the object of which is the transfer or acquisition of ownership or other real rights in immovable property;</p> <p>1.2. encumbrances of mortgage on immovable property;.</p> <p>2. Legal transactions as per paragraph 1 and 4 of this Article that are set forth in the form of a notarized deed shall have the same evidentiary effect as acts made in the</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 40 Obaveznost javnobeležničkog dokumenta</b></p> <p>1. U obliku javnobeležničkog dokumenta se u skladu sa članom 42 ovog zakona sačinjavaju:</p> <p>1.1. pravni poslovi predmet kojih je prenošenje ili sticanje vlasništva ili drugih stvarnih prava u nekretninama;</p> <p>1.2. uspostavljanje hipoteke na nepokretnu imovinu.</p> <p>2. Pravni poslovi iz stava 1 i 4 ovog člana koji su sačinjeni u obliku javnobeležničkog dokumenta imaju istu dokaznu snagu kao da su sačinjeni u sudu ili pred drugim</p>

<p>apo në organet e administratës.</p> <p>3. Punët juridike nga paragrafi 1 dhe 4 i këtij neni të cilët nuk janë përpiluar në formën e aktit noterial nuk prodhojnë efekt juridik.</p> <p>4. Forma e aktit noterial për disa punë juridike mund të parashihet edhe me ligje të tjera.</p> <p>5. Palët mund të kërkojnë formën e aktit noterial edhe për punët e tjera juridike të cilat nuk janë paraparë në paragrafin 1 të këtij neni.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 41</b> <b>Solemnizimi i dokumenteve të hartuara nga pala apo përfaqësuesi i tij</b></p> <p>1. Dokumentet e hartuara nga pala apo përfaqësuesi i tij duhet të solemnizohen nga noteri për rastet si në vijim:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. marrëveshjet për marrëdhëniet pasurore në mes të bashkëshortëve apo të bashkëshortëve jashtëmartesore;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2 marrëveshja për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët në mes të bashkëshortëve apo bashkëshortëve jashtëmartesor;</p>	<p>court or administrative bodies.</p> <p>3. Legal transactions as per paragraphs 1 and 4 of this Article not set forth in the form of a notarized deed shall have no legal effect.</p> <p>4. The form of a notarized deed for certain legal transactions may be prescribed by other laws.</p> <p>5. Parties may require the form of a notarized deed for other legal transactions which are not provided for by paragraph 1 of this Article.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 41</b> <b>Formalization of documents drafted by a party or its representative</b></p> <p>1. Documents drafted by a party or its representative shall be formalized by the notary in the following instances:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. agreement on property relations between spouses or extramarital partners;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2. agreement on division of joint property between spouses or extramarital partners;</p>	<p>državnim organima.</p> <p>3. Pravni poslovi iz stava 1 i 4 ovog člana koji nisu sačinjeni u obliku javnobeležničkog dokumenta ne proizvode pravno dejstvo.</p> <p>4. Sačinjavanje javnobeležničkog dokument u nekim pravnim poslovima može biti predviđeno i drugim zakonima.</p> <p>5. Stranke mogu tražiti sačinjavanje oblika javnobeležničkog dokumenta i za druge pravne poslove koji nisu predviđeni stavom 1 ovog člana.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 41</b> <b>Overavanje (solemnizacija) dokumenata koje je sačinila stranka ili zastupnik iste</b></p> <p>1. Dokumenta koja je sačinila stranka ili zastupnik iste će solemnizovati notar u sledećim slučajevima:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. sporazumi o imovinskim odnosima između supružnika ili vanbračnim supružnicima;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2. sporazumi o podeli zajedničke imovine među supružnicima ili vanbračnim supružnicima;</p>
--	--	--

<p>1.3.marrëveshjet për administrimin dhe disponimin e pasurisë së përbashkët të anëtarëve të bashkësisë familjare;</p> <p>1.4. ujdia për alimentacion në mes të bashkëshortëve.</p> <p>2. Noteri mund ta shkruaj solemnizimin në fund të dokumentit të përgatitur nga palët, ose në një faqe të veçantë. Në këtë rast, solemnizimin i bashkëngjitet dokumentit.</p> <p>3. Noteri duhet t’ua lexoj palëve solemnizimin, të iu shpjegoj atyre pasojat ligjore të kontratës dhe të verifikoj vullnetin e tyre përfundimtar.</p> <p>4. Në procesin e solemnizimit zbatohet akti përkatës nënligjore rreth arkivave, librave dhe lëshimit të kopjeve.</p> <p>5. Me rastin e solemnizimit, noteri duhet të konfirmoj identitetin dhe cilësinë e palëve, ekzistencën e personave juridikë, nëse ka ndonjë, dhe ligjshmërinë e kontratës në pajtim me nenet 33, 34, 35 dhe 40 të këtij Ligji.</p> <p>6.Dokumenti nga paragrafi 1 i këtij neni, pas solemnizimit ka fuqinë provuese dhe është dokument përmbarimor.</p>	<p>1.3. agreements on administration and disposal of joint property of members of a family union;</p> <p>1.4. alimony settlement between spouses.</p> <p>2. A notary may write his/her formalization act by the end of the document drafted by the party, or in a single sheet. In this case, the formalization is attached to the original document.</p> <p>3. The notary shall read aloud the formalization before the parties, and explain the legal effects of the contract, and validate their final will.</p> <p>4. Relevant secondary legislation on archives, records and issuance of copies shall apply in the act of formalization.</p> <p>5. When formalizing a document, the notary shall confirm the identity and capacity of parties, the existence of legal persons, if any, and the legality of contract in accordance with Articles 33, 34, 35 and 40 of the present Law.</p> <p>6. Upon formalization, a document meeting the requirements of paragraph 1 of the present Article shall have evidentiary effect and shall be an executive title.</p>	<p>1.3. sporazumi o upravljanju ili raspolaganju zajedničkom imovinom članova porodične zajednice;</p> <p>1.4. dogovori supružnika o alimentaciji.</p> <p>2. Notar može sačiniti solemnizaciju na kraju dokumenta koji je sačinila stranka, ili na posebnoj stranici. U ovom slučaju, solemnizacija se prilaže dokumentu.</p> <p>3. Notar će strankama pročitati solemnizaciju, objasniti im pravne posledice ugovora i potvrditi njihovu konačnu volju.</p> <p>4. U postupku solemnizacije se primenjuje relevantni podzakonski akt o arhivama, knjigama i izdavanju kopija.</p> <p>5. Prilikom solemnizacije, notar potvrđuje identitet i svojstvo stranaka, prisustvo pravnih lica, ako ih ima, i zakonitost ugovora u skladu sa članovima 33., 34., 35. i 40. ovog Zakona.</p> <p>6. Dokument iz stava 1. ovog člana, posle solemnizacije, dobija snagu i smatra se izvršnim dokumentom.</p>
---	---	--



<p style="text-align: center;"><b>Neni 42</b> <b>Përmbajtja e dokumentit noterial</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 42</b> <b>Contents of a Notarized Deed</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 42</b> <b>Sadržaj javnobeležnicke isprave</b></p>
<p>1. Dokumenti noterial përmban:</p> <p>1.1. emrin dhe mbiemrin si dhe selia e noterit;</p> <p>1.2. emrin dhe mbiemrin, vendin dhe datën e lindjes, adresën dhe numrin personal të pjesëmarrësve, përfaqësuesit e tyre ligjor dhe të autorizuarve, ndërsa për personin juridik emërtimi dhe selia e tij, numri mbi regjistrimin në regjistër, emrin dhe mbiemrin, adresën dhe vendbanimin e përfaqësuesit të personit juridik;</p> <p>1.3. dokumentet për mënyrën e verifikimit të identitetit të personave nga paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 i këtij neni si dhe organi i cili e ka lëshuar dokumentin;</p> <p>1.4. tekstin e përmbajtjes së punës juridike dhe shënimi i dokumenteve, të cilat i bashkëngjiten aktit noterial siç janë autorizimet, ekstraktet nga librat amë, ekstraktet dhe kopjet nga kadastri tokësor dhe nga librat e tjerë publik si</p>	<p>1. A notarized deed shall contain:</p> <p>1.1. The name, surname and seat of Notary;</p> <p>1.2. the name and surname, place and date of birth, and personal numbers of parties, their legal counsels and proxies; for legal persons, name and seat, registration number, name and surname, address and place of residence of legal person representative;</p> <p>1.3. documents for confirmation of identity of persons as per paragraph 1, sub-paragraph 1.2 of this Article, and the authority issuing the document;</p> <p>1.4. text of legal transaction and reference to documents to be attached to the notarized deed, such as authorizations, extracts from registers, and copies from land cadastre, other public records and fees for legal</p>	<p>1. Javnobeležnicka isprava sadrzi:</p> <p>1.1. ime i prezime kao i sediste notera;</p> <p>1.2. ime i prezime, mesto i datum rođenja, adresu i licni broj ucesnika, njihovih zakonskih zastupnika i ovlascenih lica, dok za zakonsko lice njegov naziv i registarski broj u registru, ime i prezime, adresu i prebivaliste zastupnika zakonskog lica;</p> <p>1.3. dokumente za načine identifikacije lica iz člana 1, odeljak 1.2 ovoga člana kao i organa koji je izdao dokument;</p> <p>1.4. tekst sadrzine pravnog posla i zapis dokumenata, koje se pridodaju javnobeležnickej ispravi poput ovlascenja, izvoda iz maticnih knjiga, izvoda i kopije zemljisnog katastra i ostalih javnih knjiga kao tarifa za pravni</p>

<p>dhe tarifa e punës juridike;</p> <p>1.5 vendin, datën dhe orën e përpilimit të aktit noterial;</p> <p>1.6. deklaratën, se pjesëmarrësit e kanë kuptuar përmbajtjen e punës juridike dhe se janë të pajtimit me aktin të cilin e ka përpiluar noteri;</p> <p>1.7. nënshkrimi i pjesëmarrësve dhe i noterit si dhe vula e noterit.</p> <p>1.8. Për punët juridike nga paragrafi 1.1. i nenit 40 të këtij Ligji, vlerësimi i vlerës së pasurisë i vlerësuesit të licencuar të pasurisë, bazuar në dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi.</p> <p>2. Akti noterial i cili nuk përmban të dhënat e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni nuk e ka cilësinë dhe as efektin juridik të dokumentit noterial.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 43</b> <b>Përmbartshmëria e dokumentit noterial</b></p> <p>1. Dokumenti noterial është dokument përmbartimor në qoftë se është përpiluar në formën e paraparë dhe nëse në të është përcaktuar kryerja e detyrimit të caktuar</p>	<p>activitie;</p> <p>1.5. Venue, date and time of processing of the notarized deed;</p> <p>1.6. Declaration of parties of their understanding of content of legal transaction, and their agreement with the act processed by the notary;</p> <p>1.7. Signature of parties and notary, and seal of the notary.</p> <p>1.8. On legal activities referred in paragraph 1.1. Article 40 of this law, property assessment can be done by a licensed estimator of the property, based on the relevant provisions of the legislation in force.</p> <p>2. A notarized deed failing to contain all items of paragraph 1 of this Article shall not have the force or legal effect of a notarized deed.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 43</b> <b>Enforceability of a notarized deed</b></p> <p>1. A notarized deed prepared in accordance with relevant procedures is directly enforceable, provided that it includes valid mandatory provisions agreed upon by the</p>	<p>posao;</p> <p>1.5. mesto, datum i sat sastavljenog javnobelesnicke isprave;</p> <p>1.6. izjavu da su ucesnici razumeli sadrzaj pravnog posla i da se slazu sa javnobelesnickom ispravom sastavljenom od strane javnobelesznika;</p> <p>1.7. potpise ucesnika, potpis notera kao i noterski pecat.</p> <p>1.8. Ugovoreni pravni posao od paragrafa 1.1. Član 40 ovog Zakona, mišljenje licenciranog ocenjivača imovine, u skladu sa odredbama važećeg zakon,</p> <p>2. Javnobelesnicki isprava koja ne sadrzi podatke utvrđene iz odeljka 1 ovoga člana , nema svojstvo i pravni efekat javnobelesnickog isprave.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 43</b> <b>Izvrnost javnobelesnickog zapisa</b></p> <p>1. Javnobelesnicki zapis je izvrсна isprava ukoliko je sacinjen u predviđenom obliku i ukoliko je u njemu utvrđena obaveza na cinidbu oko koje se stranke mogu</p>
--	---	---

<p>për të cilën palët mund të merren vesh dhe nëse përmban deklaratën e detyruesit për atë që në bazë të atij dokumenti, mundet, e me qëllim të realizimit të detyrimit, pas arritshmërisë së detyrimit, në mënyrë të drejtpërdrejt të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm.</p> <p>2. Nëse dokumenti noterial nga ky nen është përpiluar në bazë të autorizimit, autorizimi duhet të jetë i vërtetuar në gjykatë apo te noteri dhe të bashkangjitura në origjinal apo në kopjen e vërtetuar.</p> <p>3. Regjistrimi në regjistrin e të drejtave pronësore në paluajtshmëri në kadastër në bazë të dokumentit noterial, i cili përmban detyrimin e themelimit, bartjes, kufizimit apo pushimit të ndonjë të drejte mbi pronën e paluajtshme, duhet të kryhet regjistrimi në regjistër sipas ligjit në fuqi, nëse personi i detyruar shprehimisht është pajtuar për atë në dokumentin noterial.</p> <p>4. Kur obligimi varet nga kushti apo afati i cili nuk është i caktuar në mënyrë kalendarike, për përmbarueshmërinë e dokumentit noterial, nëse në atë dokument noterial palët ndryshe nuk janë marr vesh duhet që me dokument të provohet se ka arrit kushti përkatësisht afati, e nëse kjo nuk është e mundshme atëherë kjo do të</p>	<p>parties, and a statement of the party required to perform certain action, to the effect that direct and compulsory enforcement of the obligation may be carried out pursuant to the notarized deed, upon maturity of the obligation.</p> <p>2. If an original notarized deed under this Article is prepared in compliance with an authorization, such authorization shall have been certified by a Court or notary, attached in its original form or as a certified copy.</p> <p>3. The registration of ownership rights over immovable property in the land cadastre shall occur on the basis of the notarized deed setting forth an obligation to create, transfer, limit or cancel real rights over real estate, subject to the debtor's express consent thereto in the notarized deed.</p> <p>4. Where the obligation arising out of the notarized deed is made to depend upon certain conditions or is subject to a deadline that is not determined on the basis of the calendar, the notarized deed shall have executive authority once a further notarized deed is prepared in which it is stated that the condition is met, or the deadline has been</p>	<p>sporazumeti, i ukoliko sadrzi izjavu obavezenog lica da se na osnovu te isprave moze, radi ostvarenja prinudne cinidbe po dospelosti obaveze neposredno sprovesti prinudno izvrsenje.</p> <p>2. Ukoliko je javnobeleznicki zapis sacinjen na osnovu ovlascenja; ovlascenje treba biti overeno od strane suda ili javnobelezhnika i pridodano u originalu ili overenoj kopiji.</p> <p>3. Na osnovu javnobeleznickog zapisa koji sadrzi obavezu zasnivanja, prenosa, ogranicenja ili ukidanja nekog prava koje se upisuje u registre nepokretnosti moze se neposredno sprovesti upis u registar ako je lice koje se obavezuje u tom zapisu izricito na to pristalo.</p> <p>4. Ako obaveza zavisi od nastupanja uslova ili isteka roka koji nije kalendariski određen, za izvrsnost javnobeleznickog zapisa, ako se strane u tom zapisu drukcije ne dogovore, potrebno je da se javnom ispravom, ili ispravom na kojoj je overen potpis poverioca, a ako to nije moguće pravosnaznom parnicnom presudom utvrdi</p>
--	---	--

<p>vërtetohet me aktgjykim në procedurën kontestimore.</p> <p>5. Përmbartimi i dokumentit noterial mund të kundërshtohet sipas dispozitave të ligjit të procedurës përmbartimore.</p> <p>6. Në rastet kur dokumenti noterial është dokument përmbartimor sipas këtij neni, noteri me kërkesën e palës, vet e vënë në dokument vërtetimin për përmbartueshmërinë.</p>	<p>met. Where it is not possible to prepare such further notarized deed, a decision by the competent court is required.</p> <p>5. Enforcement of a notarized deed may be challenged according to legal provisions of executive procedure.</p> <p>6. In cases when the notarized deed has executive authority pursuant to this Law, and by request of the party, the notary notes in the deed the confirmation of enforceability.</p>	<p>da je uslov nastupio,odnosno da je rok istekao.</p> <p>5. Izvrnost javnobelesnickog zapisa moze se pobijati sporiti po odredbama zakona kojima se uređuje izvrni postupak.</p> <p>6. U slucajevima kad je javnobelesnicki zapis izvrna isprava,shodno shodno ovom članu, noter na zahtev stranke sam stavlja potvrdu o izvrnosti na ispravu.</p>
<p><b>KAPITULLI VIII - PROCESVERBALET NOTERIAL</b></p>	<p><b>CHAPTER VIII - NOTARY MINUTES</b></p>	<p><b>POGLAVLJE VIII - JAVNOBELEZNICKI ZAPISNICI</b></p>
<p><b>Neni 44</b> <b>Punët për të cilat përpilohen procesverbalet noteriale</b></p>	<p><b>Article 44</b> <b>Issues for which notary minutes are kept</b></p>	<p><b>Član 44</b> <b>Delatnosti na koje se nadovezuju javnobelesnicki zapisi</b></p>
<p>1. Noteri është i autorizuar që në formën e procesverbalit noterial të vërtetojë ekzistimin e fakteve nga të cilat varet vlefshmëria e punës juridike dhe plotësimi i detyrimeve që dalin nga ai fakt, në veçanti oferta, vërejtja, heqja dorë, prishja e kontrata, etj.</p> <p>2. Noteri në formën e procesverbalit noterial mund:</p>	<p>1. A notary is authorized to keep notes in the form of notary minutes to ascertain the existence of facts, on which the validity of a legal transaction and performance of obligations depend, especially for an offer, consideration, withdrawal, contract annulment, etc.</p> <p>2. The notary may, in the form of notary minutes:</p>	<p>1. Noter je opunomocen da u obliku javnobelesnickog zapisnika overi postojanje cinjenica od kojih zavisi vrednost pravnog posla i ispunjavanje obaveza koje od njih proizilaze , posebno ponuda, odustanak,ponistenje ugovora itd.</p> <p>2. u obliku zapisnika noter moze da:</p>

<p>2.1. të përpiloj procesverbal për regjistrimin dhe vlerësimin e masës së trashëgimisë, me pjesëmarrjen e detyrueshme të ekspertit;</p> <p>2.2. të lidh ujdj apo aktpajtim para organit administrativ para fillimit të procedurës kontestimore, jokontestimore dhe administrative në pajtim me ligjin, me efektin e ujdisë gjyqësore përkatësisht të akt pajtimit të lidhur para organeve të administratës;</p> <p>2.3. të përpiloj procesverbal për besimin në ruajtjen e testamentit të përpiluar me dorën e vet, të testamentit të shkruar në prezencën e dëshmitarëve dhe të testamentit noterial;</p> <p>2.4. me procesverbal të merr deklaratën nga kreditori për vazhdimin e afatit për përmbarrim për detyrimin e debitorit të përcaktuar në dokumentin përmbarrimor;</p> <p>2.5. të merr me procesverbal edhe deklaratat tjera apo vërtetojë faktet tjera të përcaktuara me ligj.</p>	<p>2.1. compile minutes on registration and appraisal of an inheritance estate, with the mandatory attendance of an expert;</p> <p>2.2. enter into a settlement or act of reconciliation before the initiation of contested, non-contested and administrative proceedings in accordance with the law, with the effect of a court settlement or act of reconciliation entered into before administrative bodies;</p> <p>2.3. compile minutes on the authenticity of handwritten wills, testaments written in the presence of witnesses, and a notary will;</p> <p>2.4. compile minutes of a deposition of a creditor to extend the deadline of enforcement for the obligation of a debtor as prescribed by enforcement title;</p> <p>2.5. record in minutes other statements or ascertain other facts as prescribed by law.</p>	<p>2.1. sastavlja zapisnik o registraciji i meri procenjivanja obima nasledstva uz obavezno ucesce vestaka;</p> <p>2.2. sklapa sporazum ili dogovor o poravnjanju pre pokretanja parnicnog, vanparnicnog ili upravnog postupka, po pravilima zakona kojim se uređuju parnicni, vanparnicni, izvrsni ili opsti upravni postupak sa dejstvom sudskog poravnjanja ondosno poravnjanja zakljucenog pred organom uprave;</p> <p>2.3. sastavlja zapis o poverenju na cuvanje svojerucno sastavljenog testamenta, testamenta sastavljenog u prisustvu svedoka i javnobeleznickog testamenta sa dejstvom sudske verodostojnosti;</p> <p>2.4. zapisom uzme izjavu poverioca o proizvodavanju roka za izvrsnost obaveze duznika odredeno javnobeleznickom izvrsnom ispravom;</p> <p>2.5. zapisom da uzme i ostale izjave ili overi ostale cinjenice odredene zakonom.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 45</b> <b>Përmbajtja e procesverbalit noterial</b></p> <p>1. Procesverbali përmban të dhënat për ditën dhe orën e njohurisë përkatësisht të vërtetimit të faktit të caktuar dhe përshkrimin e saktë të asaj që ka ndodh në prezencën e noterit dhe të asaj që noteri drejtpërdrejt e ka vërtetuar.</p> <p>2. Procesverbali noterial përmban kohën dhe vendin e përpilimit të procesverbalit.</p> <p>3. Procesverbali noterial i cili nuk përmban të dhënat e parapara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni nuk e ka cilësinë dhe efektin juridik të dokumentit noterial.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 45</b> <b>Contents of Notary Minutes</b></p> <p>1. Minutes shall contain records of the date and time of acquiring knowledge, namely of certification of fact recorded, and full description of the events occurring before the notary, and facts confirmed directly by the notary.</p> <p>2. Notary minutes shall also contain time and venue of minutes kept.</p> <p>3. Notary minutes that do not contain the items as per paragraph 1 and 2 of this Article shall have no capacity or legal effect of a notarized deed.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 45</b> <b>Sadržaj javnobelesničkog zapisnika</b></p> <p>1. Zapisnik sadrži znane podatke o danu i satu odnosno overu i tacan opis određenih cinjenica onoga sto se izdesavalo u prisustvu notera i onoga sto je noter neposredno ustanovio.</p> <p>2. Javnobelesnički zapis sadrži vreme i mesto sastavljanja zapisnika.</p> <p>3. Javnobelesnički zapis koji ne sadrži podatke određene u odeljku 1 i 2 ovog člana nema pravno svojstvo i dejstvo javnobelesničkog zapisa.</p>
<p style="text-align: center;"><b>KAPITULLI IX - KONFIRMIMI I FAKTEVE, VËRTETIMI I DOKUMENTEVE, PRANIMI I DEKLARATAVE NËN BETIM</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>CHAPTER IX - CONFIRMATION OF FACTS, CERTIFICATION OF DOCUMENTS, RECEIPT OF SWORN STATEMENTS</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>POGLAVLJE IX - OVERA CINJENICA ,OVERA DOKUMENATA, UZIMANJE IZJAVA POD ZAKLETVOM</b></p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 46</b> <b>Kushtet e përgjithshme</b></p> <p>1. Me rastin e lëshimit të vërtetimeve dhe konfirmimeve, noteri:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. konstaton identitetin e palës që bën kërkesën, ashtu siç parashihet në</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 46</b> <b>General requirements</b></p> <p>1. Upon issuing certifications and confirmations, the notary shall:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. ascertain the identity of the requesting party or parties, as envisioned</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 46</b> <b>Opsti uslovi</b></p> <p>1. Povodom izdavanja potvrda i sertifikata, noter:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. Utvrđuje identitet stranke koja podnosi zahtev, kako je i predviđeno</p>

<p>nenin 35 të këtij ligji; dhe</p> <p>1.2. shton klauzolën për vërtetimin apo konfirmimin, deklaron datën e vërtetimit apo konfirmimit, dhe e vë nënshkrimin dhe vulën zyrtare të tij.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 47</b> <b>Vërtetimi i kopjeve të dokumenteve origjinale</b></p> <p>1. Noteri vërteton vetëm kopjet e dokumenteve origjinale të përgatitura në zyrën e noterit. Noteri mund të vërtetojë gjithashtu kopjet e dokumenteve origjinale të sjellura nga palët për vërtetim, me kusht që kopja e dokumentit të jetë bërë në zyrën e noterit.</p> <p>2. Kopja duhet të përputhet në çdo aspekt me dokumentin origjinal, përfshirë këtu shkrimin, pikësimin dhe shkurtesat e fjalëve. Nëse pjesët e dokumentit origjinal janë ndryshuar, fshirë, janë shënjuar me vija, janë futur apo shtuar në tekst, kjo duhet të pasqyrohet në vërtetim. Në vërtetim tregohet nëse dokumenti origjinal është grisur, dëmtuar apo në ndonjë formë tjetër duket i dyshimtë në pamjen e tij, përveç kur është e qartë nga kopja apo fotokopja e dokumentit.</p> <p>3. Noteri krahason me kujdes dhe saktësi</p>	<p>in Article 35 of this law; and,</p> <p>1.2. add the certification or confirmation clause, state the date of certification or confirmation, his signature and his official seal.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 47</b> <b>Certification of copies of original documents</b></p> <p>1. A Notary shall only certify copies of original documents prepared in the notary office. A Notary may also certify copies of original documents brought for certification by a party, provided copy of the document is made in the notary office.</p> <p>2. The copy must conform in all regards to the original document, including in respect of writing, punctuation and abbreviation of words. If parts of the original document were altered, deleted, strike-through, inserted-to or added-to, this shall be reflected in the certification. The certification shall indicate whether the original document was torn, damaged or otherwise suspicious in its appearance, except where it is obvious from the very copy or photocopy of the document.</p> <p>3. The Notary shall carefully and accurately</p>	<p>članom 35 ovog zakona; i</p> <p>1.2. dodaje klauzulu potvrđvanja ili sertifikat, izjavljuje datum potvrde ili sertifikata, i stavlja svoj potpis i službeni pecat.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 47</b> <b>Overa kopija originalnih dokumenata</b></p> <p>1. Noter overava samo kopije originalnih isprava sastavljenih u kancelariji notera. Noter može da takođe overi i kopije isprava donesenih od stranke za overu, pod uslovom da je kopija isprave sastavljena u noterskoj kancelariji.</p> <p>2. Kopija treba da se podudara u svakom aspektu sa originalnom ispravom uključujući i rukopis, interpunkciju i skracenice reci. Ukoliko su se delovi originalne isprave izmenili, izbrisali, podvukli linijom, dodani ili ubaceni u tekst, ovo treba da se odgleda u potvrđi. U potvrđi se prikaze ukoliko je originalna isprava iscepana, oštećena ili se cini sumnjivom na neki drugi način, osim kada je jasna od kopija ili fotokopija isprave.</p> <p>3. Noter pažljivo i tačno upoređuje kopiju sa</p>
---	--	--

<p>kopjen me origjinalin dhe konstaton që të dyja këto përshtaten. Nëse noteri konstaton këtë, ai përfshin në deklaratë lidhur me këtë për kopjen e bërë. Noteri më tej shton:</p> <p>3.1. që kopja është e dokumentit të përcaktuar si origjinal nga palët;</p> <p>3.2. nëse është kopje e dokumentit të certifikuar apo kopje e zakonshme e dokumentit origjinal, dhe në këtë rast noteri deklaron që kopja përputhet në çdo aspekt me kopjen, më parë se me dokumentin origjinal, që nuk i është prezantuar atij;</p> <p>3.3. nëse dokumenti origjinal është shkruar me dorë apo me makinë shkrimi ose me ndonjë mjet tjetër të mekanizuar apo elektronik, ose me mjete kimike, me laps ose stilograf; dhe</p> <p>3.4. nëse origjinali i dokumentit është gjetur në bazë të njohurive të vet noterit apo në bazë të deklarimeve të palës; dhe</p> <p>3.5. nëse pala ka sjellë dokumentin për vërtetim, emrin dhe adresën e asaj pale.</p>	<p>compare the copy with the original and ascertain that the two (2) match. Should the notary so conclude, he or she shall include a statement to this effect on the copy made. The notary shall further add:</p> <p>3.1. that the copy is of a document designated as an original by the party; or</p> <p>3.2. whether it is a copy of a certified or ordinary copy of an original document, in which case the notary shall state that the copy conforms in all regards to the copy, rather than the original document, which was not presented to him or her;</p> <p>3.3. whether the original document was written by hand or with a typing machine or another mechanized or electronic device or by chemical means, by pencil or pen; and</p> <p>3.4. where the original of the document is located according to the notary's own knowledge or on the basis of the statements of the party or parties; and</p> <p>3.5. if the party brought the document to be certified, the name and address of that party.</p>	<p>originalom i zaključuje da se podudaraju. Ukoliko notar ustanovi to, on to obuhvaca u izjavi vezanoj za uradenu kopiju. Noter dalje dodaje:</p> <p>3.1. da je kopija isprave utvrđena kao original od stranki;</p> <p>3.2. ukoliko je u pitanju potvrđena kopija ili obična kopija originalne isprave, javni beleznik tom prilikom izjavljuje da se kopija podudara u svakom aspektu sa kopijom,pre nego sa originalnom ispravom koja njemu nije predocena na uvid;</p> <p>3.3. ukoliko je originalna isprava napisana rukom ili masinom za kucanje ili nekom drugom mehanickom ili elektronskom napravom,ili hemiskom olovkom,olovkom ili penkalom; i</p> <p>3.4. ukoliko je originalna isprava pronađena zasnivajući se saznanju samog notera, ili na osnovu izjave stranke; i</p> <p>3.5. ukoliko je stranka prinela ispravu za potvrdu, ime i prezime te stranke.</p>
--	---	--



<p>4. Kur bëhet vërtetimi i kopjes së një pjese të dokumentit, apo ekstraktit nga dokumenti, kopja duhet të tregojë qartë se cilat pjesë të dokumenteve nuk janë kopjuar.</p>	<p>4. Where certification is made of the copy of one part of a document, or of an extract from a document, the copy shall clearly indicate which parts of the document have not been copied.</p>	<p>4. Kada se overava kopija jednog dela isprave, ili izvoda isprave, kopija treba jasno pokazuje koji se delovi nisu kopirali.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 48</b> <b>Vërtetimi i nënshkrimit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 48</b> <b>Certification of Signature</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 48</b> <b>Overa potpisa</b></p>
<p>1. Noteri mund të vërtetojë që pala personalisht ka nënshkruar dokumentin në praninë e tij, apo që nënshkrimi, që tanimë ka qenë në atë dokument, është vërtetuar nga pala si shkrim i tij.</p>	<p>1. The notary may certify that a party personally signed a document in his or her presence, or that the signature, which already figured on the document, was confirmed by the party as being of his or her hand.</p>	<p>1. Noter može utvrditi da je stranka licno potpisala sudsku ispravu u njegovom prisustvu, ili da je potpis koji se vec nalazi na toj ispravi potvrđen od stranke kao vlastit.</p>
<p>2. Klauzola e vërtetimit duhet të përpilohet në dokumentin origjinal, duke treguar mënyrën në të cilën është konstatuar identiteti i nënshkruesit, dhe shtojcën që dëshmon se nënshkrimi është i vërtetë. Nën shtojcë duhet shënuar datën, që përcillet me nënshkrimin e noterit dhe vulën e tij zyrtare.</p>	<p>2. The certification clause shall be drawn on the original writ, with indication of the manner in which the identity of the signatory was ascertained, and an addendum to the effect that the signature is true. Under the addendum, the date shall be entered, followed by the notary's signature and his or her official seal.</p>	<p>2. Klauzula o potvrđivanju se treba sastaviti u originalnom sudskom dokumentu iskazujući način na koji je ustanovljen identitet potpisnika, i dodatak koji svedoci da je potpis pravi. U dodatku treba uneti datum, koji je popracen potpisom javnog beležnika i njegovim zvanicnim pecatom.</p>
<p>3. Nëse pala që kërkon vërtetimin e nënshkrimit të tij është e verbër apo nuk din shkrim dhe lexim noteri lexon dokumentin para tij para se të vërtetojë nënshkrimin. Në këtë rast, kërkohet të jenë të pranishëm dy (2) dëshmitarë, në pajtim me dispozitat e nenit 37 të këtij ligji. Në fund, nëse noteri nuk e njeh gjuhën e</p>	<p>3. Should the party requesting certification of his or her signature be blind or illiterate, the notary shall read document to him before certifying the signature. In such a case, the presence of two (2) witnesses is further required, in accordance with the provisions of Article 37 of this Law. Finally, should the Notary not know the</p>	<p>3. Ukoliko je stranka koja zahteva overu njenog potpisa slepa ili ne ume da cita i pise, javni beleznik procita sudsku odredbu ispred nje pre nego sto overi potpis. U ovom slucaju je potrebno prisustvo (2) svedoka, u skladu sa odredbama Člana 37ovog zakona. Na kraju ukoliko noter ne poznaje jezik isprave, on ce biti procitan od strane</p>

<p>dokumentit, ai do të lexohet nga ana e përkthyesit. Pjesëmarrja e dy (2) dëshmitarëve dhe/apo përkthyesit duhet të pasqyrohet në vërtetim.</p> <p>4. Nëse kërkohet vërtetimi i nënshkrimit të personit që vepron si përfaqësues i personit juridik apo agjencisë, noteri konfirmon vërtetimin që personi në fjalë ka nënshkruar dokumentin në emër të personit juridik apo agjencisë përkatëse. Sidoqoftë, ai mund ta bëjë këtë vetëm pasi të ketë vërtetuar se personi është i autorizuar për këtë qëllim.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 49</b> <b>Vërtetimi i datës</b></p> <p>Noteri mund të konfirmojë kohën kur është prezantuar dokumenti para tij, apo para palës së tretë në praninë e tij. Kjo konfirmohet në dokumentin përkatës, duke treguar ditën, muajin dhe vitin e prezantimit të dokumentit para tij. Noteri mund të shtojë edhe orën kur është bërë prezantimi, me kërkesë të palës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 50</b> <b>Vërtetimi që personi është i gjallë</b></p> <p>1. Noteri mund të konfirmojë që një</p>	<p>language of the document, the document shall be read by an interpreter. The participation of two (2) witnesses and/or an interpreter shall be reflected in the certification.</p> <p>4. If certification is requested of the signature of a person acting as a representative of a legal person or agency, the Notary shall confirm in the certification that the person concerned signed the document on behalf of the legal person or agency concerned. However, he or she may do so only after being satisfied that the person is authorized to do so.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 49</b> <b>Authentication of date</b></p> <p>The notary may confirm the time when document was presented to him or her, or to a third party in his or her presence. This shall be confirmed in the relevant document, with indication of the day, month and year when the document was presented to him or her. The notary may add the hour when the presentation occurred, at the request of the party.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 50</b> <b>Confirmation that a person is alive</b></p> <p>1. A Notary may confirm that a person is</p>	<p>prevodioca. Prisustvo (2) svedoka i /ili prevodioca treba da se odgleda u uverenju.</p> <p>4. Ukoliko se zahteva overa potpisa lica koje deluje kao predstavnik pravnog lica ili agencije, noter potvrđuje uverenje da je doticno lice potpisalo sudsku odredbu u ime pravnog lica ili odgovarajuće agencije. Ma kako bilo on to može uraditi samo nakon utvrđivanja da je osoba opunomocena za to.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 49</b> <b>Potvrda datuma</b></p> <p>Noter može potvrditi vreme kada je isprava predocena ispred njega, ili pred trecom strankom u njegovom prisustvu. Ovo se potvrđuje u odgovarajućem zapisu, koji pokazuje dan, mesec i godinu predocenja sudske odredbe pred njim i javni beleznik može dodati i sat kada je urađena prezentacija na zahtev stranke.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 50</b> <b>Potvrda da je lice u zivotu</b></p> <p>1. Noter može da potvrdi da je lice u zivotu,</p>
--	--	---

<p>person është i gjallë, nëse ai e njih atë person personalisht dhe me emër, apo pasi të ketë konstatuar identitetin e atij personi në pajtim me dispozitat e nenit 35 të këtij ligji.</p> <p>2. Do të konfirmohet, në origjinalin e dokumentit të lëshuar nga pala, që personi në fjalë është prezantuar vet para Noterit. Dokumenti më tej përfshin shënimin e ditës, muajit dhe vitit, dhe nëse kërkohet nga pala, orën kur kanë ndodhur këto. Noteri do të shënojë po ashtu në konfirmim mënyrën e konstatimit të identitetit të personit.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 51</b> <b>Konfirmimi i fakteve të tjera</b></p> <p>1. Me kërkesë të palëve, noteri mund të konfirmojë faktet, punët juridike dhe ngjarjet që janë paraqitur në prani të tij, sikur që janë seancat për oferta, ankande, përpilime apo deklarime të bëra nga personat në lidhje me faktet e caktuara dhe kushtet në të cilat vet noteri, apo me pjesëmarrjen e ekspertëve në fushat përkatëse, ka mësuar faktet, punët juridike apo ngjarjet.</p> <p>2. Noteri përgatitë dokumentin origjinal lidhur me konfirmimin e fakteve që</p>	<p>alive if he or she knows that person personally and by name, or after ascertaining that person's identity pursuant to the provisions of Article 35 of this law.</p> <p>2. It shall be confirmed, in the original of the document issued to the party, that the person concerned presented himself or herself before the Notary. The document shall further comprise indication of the day, the month and the year, and, if so requested by the party, the hour when these events occurred. The notary shall further state in the confirmation how the person's identity was ascertained.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 51</b> <b>Confirmation of other facts</b></p> <p>1. At the request of the parties, the notary may confirm facts, transactions and events which occurred in his presence, such as hearings on offers, auctions, drawings or statements made by persons regarding certain facts and the conditions in which the Notary himself, or with the participation of experts in the fields concerned, learnt of the facts, transactions or events.</p> <p>2. The Notary shall prepare an original document regarding the confirmation of</p>	<p>ukoliko licno poznaje to lice imenom i prezimenom, ili nakon utvrđivanja identiteta tog lica u skladu sa odredbama člana 35 ovog zakona.</p> <p>2. Potvrđice se u originalnom zapisu izdatom stranci, da se doticno samo prezentiralo pred noterom. Dalje zapis obuhvata upisivanje dana, meseca i godine i ukoliko stranka zahteva ,sat kada se to desilo. Javni beleznik ce takođe upisati u potvrđi način određivanja identiteta lica.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član51</b> <b>Potvrda ostalih cinjenica</b></p> <p>1. Na zahtev stranaka, noter moze potvrđiti cinjenice, pravne poslove i desavanja koja su predocena u njegovom prisustvu, kao sto su sednice o javnoj ponudi, aukcijama, sastavljanju ili izjave samih stranaka u vezi ustanovljenih cinjenica i uslova pod kojim sam noter sa ili bez ucestvovanja vestaka iz odgovarajucih oblasti, je upoznao cinjenice, pravne poslove ili dogadjaje.</p> <p>2. Noter sastavlja originalnu ispravu vezanu za potvrđivanje cinjenica koje su pomenute</p>
--	--	--

<p>përmenden në paragrafin 1 të këtij neni. Në këtë dokument, noteri shënon vendin, kohën, emrat dhe adresat përkatëse të të gjitha palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë, si dhe përshkrimin preciz të fakteve, ngjarjeve apo punët juridike të lidhura në prani të tij, apo të atyre paraqitjen e të cilave e ka konstatuar ai, dhe në cilën mënyrë. Dokumenti origjinal nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit. Nëse ndonjë nga pjesëmarrësit refuzon të nënshkruajë procesverbalin, noteri e shënon këtë në dokumentin origjinal.</p> <p>3. Dokumenti origjinal i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni do të përfshijë mënyrën në të cilën është konstatuar identiteti i palës apo palëve që marrin pjesë në konfirmim, ashtu si parashihet në nenin 35 të këtij ligji.</p>	<p>facts referred-to in Paragraph 1 of this Article. In this document, the notary shall state the place, time, names and respective addresses of all parties and other participants, as well as a precise description of the facts, events or transactions occurred in his or her presence, or those whose occurrence he or she ascertained, and in which manner. The original document shall be signed by all participants. Should any of the participants refuse to sign the minutes, the Notary shall reflect this in the original document.</p> <p>3. The original document envisioned in paragraph 2 of this Article shall include the manner in which the identity of the party or parties to the confirmation was ascertained, as envisioned in Article 35 of this Law.</p>	<p>u odeljku 1 ovog člana. U ovoj ispravi, noter upisuje mesto, vreme, imena i odgovarajuće adrese svih stranaka i ostalih ucesnika, kao i opsirni opis cinjenica desavanja, ili pravnih poslova sklopljenih u njegovom prisustvu, ili onih cije je iznosenje on sam potvrdio, i na ovaj način originalna isprava se potpisuje od strane svih ucesnika. ukoliko neko od ucesnika odbije da potpise zapisnik, noter to belezi u originalnoj ispravi.</p> <p>3. Originalna pomenuta isprava u odeljku 2 ovog člana ce obuhvatitinačin na koji je utvrđen identitet stranke ili stranki koje učestvuju u potvrđivanju, kao sto je predviđeno članom 35 ovog zakona.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 52</b> <b>Pranimi i deklaratave nën betim</b></p> <p>Noteri mund të pranojë deklaratata nën betim nga palët. Deklarata e noterizuar pasqyron betimin e dhënë nga pala e interesuar, me sa vijon:</p> <p><i>“Beto hem në nderin tim që jam shprehur me sinqeritet dhe besnikërisht në përgjigje ndaj të gjitha pyetjeve që më janë bërë nga noteri për sa i përket kësaj çështjeje</i></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 52</b> <b>Receipt of sworn statements</b></p> <p>A notary may receive sworn statements from parties. The notarized statement shall reflect the oath taken by the party concerned, as follows:</p> <p><i>“I hereby swear upon my honor that I have spoken truly and faithfully in response to all questions asked to me by the notary in regard to this matter and that I have not</i></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 52</b> <b>Prihvatanje izjava pod zakletvom</b></p> <p>Noter moze prihvatiti izjave stranaka pod zakletvom. Noterska izjava odrazava datu zakletvu zainteresovane stranke kao sto sledi:</p> <p><i>“Zaklinjem se mojom cascu da sam se izrazio iskreno i verno u odgovorima na sva pitanja koja su mi bila postavljena od strane javnog beleznika sto se tice ove</i></p>

<p><i>dhe që nuk kam fshehur asnjë fakt për të cilin jam në dijeni lidhur me këtë çështje.”</i></p>	<p><i>withheld any facts known to me in regard to this matter.”</i></p>	<p><i>stvari i da nisam sakrio nijednu cinjenicu sa kojom sam upoznat u vezi ovog slucaja.”</i></p>
<p><b>KAPITULLI X - PRANIMI I DOKUMENTEVE, PARASË, LETRAVE ME VLERË DHE TË SENDEVE TË ÇMUESHME ME QËLLIM TË RUAJTJES DHE TË DORËZIMIT</b></p>	<p><b>CHAPTER X - DEPOSIT OF DOCUMENTS, CASH, SECURITIES, AND VALUABLES FOR SAFE-KEEPING AND SUBMISSION</b></p>	<p><b>POGLAVLJE X - PRIVATANJE ISPRAVA, NOVCA, VREDNOSNI H HARTIJA I DRAGOCENOSTI U CILJU CUVANJA I PREDAJE</b></p>
<p><b>Neni 53</b> <b>Ruajtja dhe dorëzimi i dokumenteve</b></p>	<p><b>Article 53</b> <b>Safe-keeping and handing over of documents</b></p>	<p><b>Član 53</b> <b>Cuvanje i predaja isprava</b></p>
